



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.19, datë 31.01.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRAT TË
PROFILIT PROKUROR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR TË
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 29 pika 1 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 166 pika 2, 183 pika 1 të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Numri maksimal i kandidatëve për magjistratë të profilit prokuror që do të pranohen në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2022-2023 është 35 (tridhjetë e pesë).
2. Raporti i përqindjeve të kuotave të kandidatëve për magjistrat të kërkuar nga Këshillat, të mbetet i pandryshuar pavarësisht nga numri i kandidatëve të pranuar nga Shkolla e Magjistraturës.
3. Të njoftohet për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

